

SHOQERIA – TRESI-FARM shpk

NUIS (NIPT) - K917280140

SELIA - Rr "Jordan MISJA" pall Eltona,nr 151 ,Tirane

### KONTRATË PËR SHITJEN E PJESËVE TË KAPITALIT

Sot më datë 03/03/2016 në seline e shoqërisë Rr.Jordan Misja,Pallati Eltona nr.151 Tirane, u paraqitën palët e mëposhtme:

Violeta Miter GOGA , lindur në Krutje-Lushnje më 18/08/1950, ,e banim në Tirane, me nr ID. 025862632,me numer personal F05818132Q me cilësinë e *shitësit*

*Dhe*

Anxhela Besim HAJDARI qytetare Tirane, lindur në Tirane, më 27/06/1990, ,e banim në Tirane, me nr ID. 029136214, me numer personal J05627064Q me cilësinë e *Blerësit*

(Shitësi dhe Blerësi do të referohen bashkërisht edhe si "Palët", ose veçmas si "Palë")

Ne palët me aftësi të plotë për të vepruar, me vullnet të lirë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil, dhe Ligjit të Shoqërive Tregtare, të Republikës së Shqipërisë, pranojmë të lidhim dhe në fakt lidhim këtë kontratë për shitjen e pjesës së kapitalit sipas kushteve të mëposhtme.

#### *Kushtet paraprake*

- Shitësi është ortak i vetëm i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar të së drejtës shqiptare TRESI FARMA shpk, me seli në adresë Rr Jordan Misja NIPT **K917280140**, dhe njekohesisht disponues në vlerën 100% (njëqind përqind) të kapitalit të shoqërisë me vlerë në leke 46,932,000 (dyzet e gjashtë milion e nenteqind e tridhjet e dy mijë) leke, në vijim (Shoqëria);
- Blerësi dëshiron të blejë dhe shitësi dëshiron të shesë 30 % (tridhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë të zotëruar nga Shitësi, sipas kushteve dhe afateve të mëposhtme:
- Shitësi ka analizuar, verifikuar dhe miratuar gjendjen pasurore, financiare dhe kontabile të Shoqërisë në momentin e lidhjes së kësaj kontrate.
- Në përputhje me nenin 117 pika b "Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave", të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 « Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare dhe në përgjithësi të legjislacionit shqiptar në fuqi, hartohet kontrata e shitjes së kuotave si më poshtë vijon:

*Meqë ekzistojnë këto kushte paraprake, palët bien dakord për sa më poshtë vijon:*

## **Neni 1- Objekti**

Në përputhje me afatet dhe kushtet e përcaktuara në këtë kontrate, Shitësi i kalon nëpërmjet shitblerjes së 30 % të kapitalit të zotëruar në shoqëri si dhe të drejtën e pronësisë mbi kuotën dhe të drejtat e tjera të lidhura me këtë pjesëmarrje Blerësit, duke e garantuar plotësisht titullin e pronësisë të pa rënduar me barrë dhe Blerësi nga ana tjetër blen nga Shitësi kuotat kundrejt një çmimi të përcaktuar në nenin 2 të kësaj kontrate.

## **Neni 2 - Çmimi i Shitjes**

Çmimi i plotë i shitjes së kuotave është 14,079,600 (katërmbëdhjet milion e shtatëdhjet e nente mije e gjashtëqint) lekë.

## **Neni 3- Blerja e pjesëve të kapitalit**

2.1 Shitësi merr përsipër t'i shesë dhe transferojë z. Anxhela Hajdari 30 % (tridhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë të zotëruar prej tij në shoqërinë TRESI FARMA SHPK sh.p.k. Blerësi merr përsipër të blejë 30 % (tridhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë TRESI FARMA SHPK sh.p.k. të zotëruar nga Shitësi në vlerën e 1 (nje) kuote, tërësisht të lire nga çfarëdolloj detyrimi në favor të të tretëve dhe me një çmim të barabartë me 14,079,600 (katërmbëdhjet milion e shtatëdhjet e nente mije e gjashtëqint) lekë.

## **Neni 4 - Pagesa**

2.2 Pagimi i çmimit nga ana e Blerësit është kryer para momentit të nënshkrimit të kësaj kontrate.

## **Neni 5- Kalimi i pronësisë**

Kalimi i pronësisë së ligjshme mbi kuotat nga Shitësi te Blerësi do të kryhet menjëherë me nënshkrimin e kontratës dhe depozitimin e kontratës në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit. Me nënshkrimin e kësaj kontrate shitësi i kalon blerësit pronësinë e 30% të kapitalit të zotëruar prej tij në shoqërinë TRESI-FARMA sh.p.k. Shitësi dhe blerësi behen bashkëortake në shoqëri respektivisht në vlerat si vijojne:

Shitësi, znj. Violeta GOGA pas transferimit nëpërmjet kësaj shitjeje do të zotërojë 1 (nje) kuote = 32,852,400 (tridhjet e dy milion e tetëqint e pesëqint e dy mije e katërqint) leke = 70 % (shtatëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë dhe,

Blerësi, znj. Anxhela Hajdari pas transferimit nëpërmjet kësaj shitjeje do të zotërojë 1 (nje) kuote



=14,079,600 (katërmbedhjet milion e shtatedhjet e nentemije e gjashtëqint) leke = 30 % (tridhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë.

#### **Neni 6 - Garancitë**

Shitësi në lidhje me kuotat që zotëron, garanton Blerësin:

Se është pronar i vetëm i kuotave të shitura e nuk ekzistojnë të drejta të parablerjes, të blerjes, të marrjes ose të opsionit të ndonjë personi të tretë në lidhje me kuotat e shitura.

Se e drejta për përfitimin e dividendit mbi kuotat e fituara në shoqërinë do të mund të ushtrohet rregullisht.

Të gjitha të mirat ekonomike të përdorura nga shoqëria, të cilat janë të nevojshme ose të dobishme për aktivitetin ekonomik të shoqërisë dhe për vazhdimin e pakufizuar të tyre pas ditës së lidhjes së Kontratës së Shitblerjes së Kuotave, veçanërisht objektet pasurore janë në pronën e vetme e shoqërisë dhe nuk janë ngarkuar me të drejta ose pretendime të të tretëve.

#### **Neni 7- Regjistrimi**

Regjistrimi i kalimit të kuotave nga Shitësi te Blerësi në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit do të kryhet menjëherë pas nënshkrimit të kontratës.

#### **Neni 8 – Ligji i zbatueshem**

Kjo kontratë rregullohet nga ligji nr. 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Ligji "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" si dhe përkatësisht dispozitat e aktit të themelimit dhe Statutit të Shoqërisë.

#### **Neni 9- Trashëgimia dhe cedimi**

Kjo kontratë do të detyrojë Palët dhe do të jetë e vlefshme midis tyre, ashtu edhe për trashëgimtarët e tyre. Në çdo rast asnjëra nga palët nuk mundet t'u kalojë të tretëve kontratën pa miratimin me shkrim të palës tjetër.

#### **Neni 10- Përmbajtja e kontratës dhe ndryshimet**

Kjo kontratë përfshin tërësisht marrëdhëniet midis palëve dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet e mëparshme që janë të lidhura me këtë objekt. Ndryshime të mundshme ose kufizime kësaj kontrate mund t'i bëhen vetëm me shkrim, të nënshkruhen nga të gjitha Palët dhe t'i bashkëngjiten asaj.



#### **Neni 11- Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Palët angazhohen të zgjidhin me mirëkuptim çdo mosmarrëveshje që lidhet me interpretimin dhe ekzekutimin e kësaj kontrate. Nëse një zgjidhje e tillë nuk është e mundur, mosmarrëveshja do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

#### **Neni 12- E drejta e zbatueshme**

Kjo kontrate dhe te drejtat e detyrimet e paleve do te disiplinohen e ushtrohen ne baze te se drejtes shqiptare.

#### **Neni 13-Vlefshmëria**

Kjo kontratë bëhet e vlefshme me nënshkrimin e saj nga palët.

#### **Neni 14- Origjinalet**

Kjo kontratë hartohet në 4 kopje origjinale, në gjuhën SHQIPE me vlere te barabarte ligjore. Kontrata pranohet nga palët dhe u gjend sipas vullnetit tone të lirë dhe të shprehur. Ajo nenshkruhet në mënyrë të rregullt, nga palët.

**Shitësi**

**Violeta GOGA**

*Violeta Goga  
Goga*

**Blerësi**

**Anxhela HAJDARI**

*Anxhela Hajdari*  
